

**DEKRET**  
**Nr.6306, datë 31.3.1981**

**PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVE TOKËSORE TË  
REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës,  
Me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Lagjja Ferrë Karicë shkëputet nga fshati Karicë i rrethit të Matit dhe formon fshat më vete me emrin "Drita" duke u lidhur me fshatin e bashkuar Baz.

**Neni 2**

Lagjja Urxalla shkëputet nga fshati Barbullej i rrethit të Matit dhe formon fshat më vete me emrin Urxalla duke u lidhur me fshatin e bashkuar Derjan.

**Neni 3**

Fshati i bashkuar Gurshpat i rrethit të Librazhdit hiqet nga ndarja administrative tokësore dhe fshatrat e tij Gurshpat e Vilan, lidhen me fshatin e bashkuar Polis të atij rrethi.

**Neni 4**

Fshatrat Domaj, Pogaj dhe Kishaj shkëputen nga fshati i bashkuar Morinë i rrethit të Kukësit dhe lidhen me fshatin e bashkuar Gjinaj të atij rrethi.

**Neni 5**

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE  
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Sekretari  
Xhafer Spahiu

Kryetari  
Haxhi Lleshi